



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 322/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.05.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Print Point” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-42611-01-29-2018, me objekt “Shpenzime të printimit dhe publikimit”, me fond limit 4.532.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

**Ankimues:**

“Promo Print” sh.p.k.  
Lagja 9, Rruga “Kiço Greco”, pranë City – Center, Korçë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Korçë  
Rruga “28 Nëntori”, Korçë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.01.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-42611-01-29-2018, me objekt “*Shpenzime të printimit dhe publikimit*”, me fond limit 4.532.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 27.02.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- |                            |                                   |
|----------------------------|-----------------------------------|
| 1. “Print Point” sh.p.k.   | 3.467.440 lekë, kualifikuar       |
| 2. “Albdesign PSP” sh.p.k. | 3.963.756 lekë, skualifikuar      |
| 3. “Promo Print” sh.p.k.   | 4.167.361 lekë, kualifikuar       |
| 4. “Andrea Zallëmi” p.f.   | 4.291.030 lekë, skualifikuar      |
| 5. “Kristalina KH” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

6. “Adel CO” sh.p.k.
7. “Farma Net” sh.p.k.

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike  
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.3. Në datën 02.03.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Në datën 06.03.2018 operatori ekonomik ankimues “Promo Print” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Print Point” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...] Nga informacioni tregëtar që ne disponojmë na rezulton se subjekti Print Point, oferta e të cilit nuk është refuzuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk plotëson kriterin: “Vertetim per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar 2017 –Dhjetor 2017 per te pakten 10 (dhjete) punonjes e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga Administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi”. Ky informacion është lehtësisht i verifikueshëm në Deklaratëa “Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” të certifikuara nga organi përgjegjës për këtë (Drejtoria e Tatimeve), në rubrika nr. 28 “Punonjës që duhet të paguajnë contribute shoqërore rezultojnë si vijon:

Viti	Muaji	Numri i Punonjësve që duhet të paguajnë kontribut shoqëror
2017	Janar	10
2017	Shkur	9
2017	Mars	11
2017	Prill	10
2017	Maj	10
2017	Qershor	9
2017	Korrik	9
2017	Gusht	9
2017	Shtator	10
2017	Tetor	10
2017	Nëntor	10
2017	Dhjetor	9
2018	Janar	9
	Mesatarisht	9.54

Pra, sic konstatohet numri i punonjësve që duhet të paguajnë kontribut shoqëror është më i ulët se numri i vendosur në Pika 1 e Krite të vecanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik. Ku thuhet shprehimisht: “Vertetim per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar 2017 –Dhjetor 2017 per te pakten 10 (dhjete) punonjes e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga Administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi”.

-Sipas informacionit tregtar të disponuar nga ne rezulton që operatori ekonomik "Print Point" sh.p.k. nuk disponon teknologji dhe për rrjedhim nuk ofron në treg shërbimet për printim, skanim dhe fotokopjim A0. Duke u nisur nga ky fakt ne paragjykojmë në vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur për vërtetimin e zotërimit të teknologjisë dhe plotësimin të kriterit të kërkuar: Makineri printimi, fotokopjim, skanim A0 i cili vërtetohet: "Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: Nje deklaratë lidhur me pajisjet qe ka ne dispozicion ku te specifikohet se autorizohet autoriteti kontraktor te verifikojë informacionin e dhene ne deklarate, e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine mbi pajisjet e mesiperme (fatura blerje te pajisjeve)". Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim." Kërkojmë të na vihet në dispozicion ky lloj dokumentacioni.

-Sipas informacionit tregëtar të disponuar nga ne rezulton se operatori ekonomik "Print Point" nuk ka pronësi sic kërkohet në kriteret e përcaktuara – Makineri shtypi. Duke u nisur nga ky fakt ne paragjykojmë në vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur për vërtetimin e zotërimit të teknologjisë dhe plotësimin të kriterit të kërkuar: Makineri shtypi cili vërtetohet: "Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: Nje deklaratë lidhur me pajisjet qe ka ne dispozicion ku te specifikohet se autorizohet autoriteti kontraktor te verifikojë informacionin e dhene ne deklarate, e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine mbi pajisjet e mesiperme (fatura blerje te pajisjeve)". Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim." Kërkojmë të na vihet në dispozicion ky lloj dokumentacioni.

-Sipas informacionit tregëtar të disponuar nga ne rezulton se operatori ekonomik "Print Point" nuk ka pronësi sic kërkohet në kriteret e përcaktuara – Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+e bardhë+llakimi (Varnish). Teknologjia e zotëruar nga Print Point nuk plotëson plotësisht kriterin e përcaktuar: Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+e bardhë+llakimi (Varnish) i cili vërtetohet: "Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: Nje deklaratë lidhur me pajisjet qe ka ne dispozicion ku te specifikohet se autorizohet autoriteti kontraktor te verifikojë informacionin e dhene ne deklarate, e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine mbi pajisjet e mesiperme (fatura blerje te pajisjeve)". Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim." Pajisja UV e zotëruar nga Print Point është e markës HP SCITEX FB950, e cila nuk i plotëson nevojat e përcaktuara në specifikimet e materialeve të kërkuara sepse nuk ofron printimin E Bardhë dhe Llakun (Varnish). Kjo vërtetohet dhe nga skeda teknike, bashkëngjitur kësaj ankese. Duke u mbështetur në faktet e mësipërme argumentojmë dhe kërkojmë sa vijon: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorite ekonomik "Printpoint" sh.p.k. në procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 12.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 1063/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar ankesën me argumentimin si më poshtë vijon:

Lidhur me pretendimin se shoqëria "Print Point" sh.p.k. nuk plotëson kriterin lidhur me numrin e punonjësve të siguruar, KSHA konstatoi se: në dokumentat e tenderit është përcaktuar kriteri si më poshtë: "Vertetim per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar 2017 –Janar 2018

per te pakten 10 (dhjete) punonjes e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga Administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi”. Për plotësimin e kriterit të mësipërm shoqëria “Print Point” sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin nr. T01145807 datë 23.02.2018 ku janë paraqitur të dhëna lidhur me numrin e personave të siguruar për periudhën Janar 2017 – Janar 2018 dhe listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi për periudhën Janar 2017- Janar 2018. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se shoqëria “Print Point” sh.p.k. rezulton se për periudhën Janar 2017 – Janar 2018 ka mesatarisht 10.23 punonjës. Për sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron. Lidhur me pretendimin se shoqëria “Print Point” sh.p.k. nuk plotëson kriterin lidhur me pajisjet e kërkuara, KSHA konstatoi se: Operatori ekonomik duhet te zoteroje pajisjet si me poshte:

-Makineri shtypi

-Makineri printim,fotokopjim, skanim A0

-Makineri per printim,stampim,materiale te ngurta,teknologjia UV,me ngjyrat CMYK+E BARDHE+LLAKIMI(VARNISH).

Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: Nje deklarate lidhur me pajisjet qe ka ne dispozicion ku te specifikohet se autorizohet autoriteti kontraktor te verifikojë informacionin e dhene ne deklarate, e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine mbi pajisjet e mesiperme (fatura blerje te pajisjeve)”. Për plotësimin e kriterit të mësipërm shoqëria “Print Point” shpk ka paraqitur: 1.Deklaratë për pajisjet që ka në dispozicion. 2.Faturat e blerjes të pajisjeve të mësipërme sipas të dhënave të shënuara në deklaratën e mësipërme në kolonën “Nr/Datë faturë blerje”. Për sa më sipër rezulton se shoqëria “Print Point” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriterin e vendosur për pajisjet në dokumentat e tenderit.

Lidhur me pretendimin e ankuesit pajisjet e deklaruara nga shoqëria “Print Point” sh.p.k. nuk janë në përputhje me specifikimet e kërkuar dhe nuk kryejnë funksionin për të cilin janë kërkuar KSHA konstatoi se: Së pari, pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime ndërkohë që është barra e ankuesit që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh. Së dyti, pavarësisht nga sa më sipër është bërë verifikimi në vend i pajisjeve të deklaruara nga ku rezultoi se pajisjet ekzistojnë dhe janë funksionale. Gjithashtu i janë kërkuar shoqërisë “Print Point” sh.p.k., materiale të prodhuara nga pajisja “Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK + E Bardhë +Llakim (Varnish). Mbasi janë vënë në dispozicion këto materiale ka rezultuar se ato janë produkte në UV, Llakimi (Varnish) e Bardhë (Ëhite). Pra makineria “Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK + E Bardhë +Llakim (Varnish)” e cila është e deklaruar nga shoqëria “Print Point” sh.p.k. dhe ndodhet në ambientet e punës të kësaj shoqërie kryen printimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu “Makineria e shtypit” dhe “Makineria e printim, stampi, skanim A0” ndodhen në ambientet e punës të shoqërisë “Print Point” sh.p.k. dhe kryejnë funksionet për të cilat janë kërkuar. Për sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron. Lidhur me kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit të paraqitur për pajisjet nga shoqëria “Print Point” sh.p.k., Ksha sqaron se nuk është në kompetencë të KSHA shqyrtimi i kërkesës për tju vënë në dispozicion dokumentacionin e ofertuesve të tjerë. KSHA sqaron dhe merr vendim vetëm për ankesat e paraqitura lidhur me vlerësimin e ofertave nga KVO. Për shqyrtimin e kërkesës tuaj duhet ti

referoheni Nenit 21 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2016 "Për prokurimin Publik". Në përfundim Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të mos pranojë ankesën e paraqitur nga shoqëria "Promo Print" sh.p.k.

II.6. Në datën 20.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në autoritetin kontraktor. Për sa i përket kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor operatori ekonomik ankimues pretendon:

*Për sa i përket listëpagesave,[...] vërtetimi i pagesës së sigurimeve shoqërore i gjeneruar nga sistemi e-albania paraqet numrin rendor në listë dhe faktin që ka apo nuk ka detyrime, jo detyrimisht ky numer përputhet me punonjësit për të cilët paguhet kontribut shoqëror dhe shëndetësor për periudhën që i referohet për shkak sepse lista ka dhe punonjësit që mund të jenë në pezullim të marrëdhënies të punës sikundër janë lejet e lindjes apo të ngjashme me to. Këtë mangësi të informacionit nga ky dokument autoriteti kontraktor e plotëson me listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Në rast se do të mjaftonte vetëm vërtetimi i pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore atëherë pse AK kërkonte edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.*

*[...] "Pajisja UV e zotëruar nga Print Point është e markës HP SCITEX FB950, e cila nuk i plotëson nevojat e përcaktuara në specifikimet e materialeve të kërkuara sepse nuk ofron printimin E Bardhë dhe Llakun (Varnish). Kjo vërtetohet dhe nga skeda teknike, bashkëngjitur kësaj ankese. Kjo pajisje i korrespondon faturave të blerjes nr. 685 dt 06.10.2010 dhe nr. 756 dt. 05.11.2010. ku specifikohet marka dhe seria përkatëse që sipas skedës teknike të gjendur në faqen zyrtare të prodhuesit të pajisjes sqarohet teknologjia dhe boja me të cilën punon kjo pajisje nje e dhënë e besueshme dhe argument i fortë Ak të bënte verifikimin në vend duke respektuar procedurën jo thjesht duke bërë një pohim të përgjithshëm dhe me nënkuptim për të mbrojtur punonjësin që ka bërë verifikimin: "U kërkuan materiale të prodhuara nga pajisja" ku procedura kërkon verifikim të pajisjes me parametrat e kërkuara të përputhura me dokumentacionin e paraqitur [...].*

*"Referuar dokumentacionit të ofruar nga "Print Point" rezulton se fatura nr. 14 datë 30.10.2010 dhe nr. 16 datë 30.10.2018 janë veprime fiktive të kryera për të justifikuar pajisje që nuk ekzistojnë, kjo vërtetohet lehtësisht nga të dhënat që ekzistojnë në regjistrin tregëtar QKB, subjekti shitës "V.V" (i afërm i administratorit-aksioner E.V) me nipt KXXXXXXXF dhe objekt veprimtarie "Internet Kafe" nuk mund të jetë tregëtar i pajisjeve të shtypit apo të tjera pajisje të pretenduara. [...].*

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1511/1 prot., datë 30.03.2018, të protokolluar me tonën në datën 03.04.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Promo Print” sh.p.k. për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Print Point” sh.p.k. me argumentin se *“nuk plotëson kriterin: “Vertetim per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar 2017 –Dhjetor 2017 per te pakten 10 (dhjete) punonjes e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga Administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën e publikuar për ndryshimet në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

*“II. Në DST, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, II. Krite te veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik, pika 1 dhe 2:*

### Ishte

*1.Vërtetim për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2017 –Dhjetor 2017 për të paktën 10 (dhjetë) punonjës e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Administrata Tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi. [...].*

### Bëhet

*1.Vërtetim për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2017 – Janar 2018 për të paktën 10 (dhjetë) punonjës e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Administrata Tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi. [...]*

III.1.2. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipër të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për periudhën Janar 2017 – Janar 2018.
- Vërtetim Nr. T00145807, datë 23.02.2018 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin – E-Sig 02/a), lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një*

*ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.5. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmëri në e tyre.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka parashikuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë se për periudhën Janar 2017 – Janar 2018 disponojnë minimumi 10 punonjës të siguruar, dokumentuar kjo me vërtetimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore lëshuar nga Administrata Tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi. Sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k., konstaton se ky i fundit në përmbushje të kërkesës së vendosur nga autoriteti kontraktor për të paktën 10 punonjës të siguruar, ka dorëzuar vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi, me anë të të cilave vërtetohet se operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k. disponon një numër mesatar punonjësish të siguruar sipas kërkesës së vendosur nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Promo Print” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Promo Print” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Print Point” sh.p.k. me argumentin se *“Sipas informacionit tregëtar të disponuar nga ne rezulton se operatori ekonomik “Print Point” nuk ka pronësi sic kërkohet në kriteret e përcaktuara – Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+e bardhë+llakimi (Varnish). Teknologjia e zotëruar nga Print Point nuk plotëson plotësisht kriterin e përcaktuar. [...] Pajisja UV e zotëruar nga Print Point është e markës HP SCITEX FB950, e cila nuk i plotëson nevojat e përcaktuara në specifikimet e materialeve të kërkuara sepse nuk ofron printimin E Bardhë dhe Llakun (Varnish). Kjo vërtetohet dhe nga skeda teknike, bashkëngjitur kësaj ankese” [...]*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën e publikuar për ndryshimet në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:



### Ishte

3. Operatori ekonomik duhet te zoteroje pajisjet si me poshte:

-Makineri shtypi

-Makineri printim,fotokopjim, skanim A0

-Makineri per printim, stampim, materiale te ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+WHITE+VARNISH

### Bëhet

3. Operatori ekonomik duhet te zoteroje pajisjet si me poshte:

-Makineri shtypi

-Makineri printim,fotokopjim, skanim A0

-Makineri per printim, stampim, materiale te ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+E BARDHE+LLAKIMI (VARNISH)

Gjithashtu, në shtojcë 7, të dokumentave të tenderit, ”Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ”Kapaciteti teknik”, pika 3, paragrafi i dytë parashikohet:

[...] ”Për pajisjet e mësipërme ofertuesi duhet të paraqesë: Një deklaratë lidhur me pajisjet që ka në dispozicion ku të specifikohet se autorizohet autoriteti kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në deklaratë, e shoqeruar me dokumentacionin që verteton pronësinë mbi pajisjet e mësipërme (fatura blerje të pajisjeve).”

III.2.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k., në lidhje me kriterin e mësipërm, rezulton se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

[...]

- Deklaratë për pajisjet që ka në dispozicion (konkretisht për pajisjet si më poshtë)
  1. Makineri shtypi
  2. Makineri printim, stampim, skanim A0
  3. Makineri, printim, stampim materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyra CMYK + Ëhite + Varnish
- Faturë Nr. 685 datë 06.10.2010, për blerjen e pajisjes “Printer HP Scitex, FB950”, me shitës “Redis Printing” sh.p.k. dhe blerës “Print Point” sh.p.k.
- Faturë Nr. 756, datë 05.11.2010 për blerjen e pajisjes “HP Scitex FB 900 Series Roll to Kit”, me shitës “Redis Printing” sh.p.k. dhe blerës “Print Point” sh.p.k.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.2.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

*përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.2.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën. [...]*

III.2.6. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Operatori ekonomik ankimes në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me pretendimin e mësipërm ndër të tjera është shprehur: [...] “Pajisja UV e zotëruar nga Print Point është e markës HP SCITEX FB950, e cila nuk i plotëson nevojat e përcaktuara në specifikimet e materialeve të kërkuara sepse nuk ofron printimin E Bardhë dhe Llakun (Varnish). Kjo vërtetohet dhe nga skeda teknike, bashkëngjitur kësaj ankese. Kjo pajisje i korrespondon faturave të blerjes nr. 685 dt 06.10.2010 dhe nr. 756 dt. 05.11.2010. ku specifikohet marka dhe seria përkatëse që sipas skedës teknike të gjendur në faqen zyrtare të prodhuesit të pajisjes sqarohet teknologjia dhe boja me të cilën punon kjo pajisje nje e dhënë e besueshme dhe argument i fortë Ak të bënte verifikimin në vend duke respektuar procedurën jo thjesht duke bërë një pohim të përgjithshëm dhe me nënkuptim për të mbrojtur punonjësën që ka bërë verifikimin: “U kërkuan materiale të prodhuara nga pajisja” ku procedura kërkon verifikim të pajisjes me parametrat e kërkuara të përputhura me dokumentacionin e paraqitur. [...].

III.2.8. Ndërkohë autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar: Lidhur me pretendimin e ankuesit pajisjet e deklaruara nga shoqëria “Print Point” sh.p.k. nuk janë në përputhje me specifikimet e kërkuar dhe nuk kryejnë funksionin për të cilin janë kërkuar kSHA konstatoi se: Së pari, pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime ndërkohë që është barra e ankuesit që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh. Së dyti, pavarësisht nga sa më sipër është bërë verifikimi në vend i pajisjeve të deklaruara nga ku rezultoi se pajisjet ekzistojnë dhe janë funksionale. Gjithashtu i janë kërkuar shoqërisë “Print Point” sh.p.k., materiale të prodhuara nga pajisja “Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK + E Bardhë +Llakim (Varnish). Mbasi janë vënë në dispozicion këto materiale ka rezultuar se ato janë produkte në UV, Llakimi (Varnish) e Bardhë (White). Pra makineria “Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK + E Bardhë +Llakim (Varnish)” e cila është e deklaruar nga shoqëria “Print Point” sh.p.k.

*dhe ndodhet në ambientet e punës të kësaj shoqërie kryen printimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. [...]*

III.2.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt prokurimi, vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që për pajisjet e mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë lidhur me disponimin e tyre si dhe faturat e blerjes së këtyre pajisjeve. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.* Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.2.10. KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k. vëren se, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e pajisjeve, operatori ekonomik ka dorëzuar deklaratën mbi pajisjet që disponon si dhe për të vërtetuar pronësinë mbi këtë pajisje ka dorëzuar faturat përkatëse të blerjes së tyre. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimes “Promo Print” sh.p.k. se pajisja UV e zotëruar nga Print Point është e markës HP SCITEX FB950, e cila nuk i plotëson nevojat e përcaktuara në specifikimet e materialeve të kërkuara sepse nuk ofron printimin e bardhë dhe llakun (Varnish), autoriteti kontraktor në informacionin e dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më anë të shkresës nr. 1511/1 datë 30.03.2018, ka bashkëlidhur edhe procesverbalin e mbajtur datë 09.03.2018, për verifikimin e pajisjeve të ndodhura në ambientet e punës të shoqërisë “Print Point” sh.p.k. ku konstatohet se *“nga verifikimi i pajisjeve që ndodhen në ambientet e punës të kësaj shoqërie rezultojnë pajisjet ekzistojnë dhe janë funksionale. Gjithashtu i janë kërkuar administratorit të shoqërisë “Print Point” sh.p.k., materiale të prodhuara nga pajisja Makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK + E Bardhë +Llakim (Varnish). Mbasi janë vënë në dispozicion këto materiale ka rezultuar se ato janë produkte në UV, Llakimi (Varnish) dhe e bardhë (White). Materialet e vëna në dispozicion i bashkëngjiten këtij procesverbali. Në përfundim të verifikimit rezultoi se makineritë e deklaruara ndodhen në ambientet e punës të shoqërisë “Print Point” sh.p.k. dhe kryejnë funksionet për të cilat janë kërkuar në tender”.* Gjithashtu, bashkëlidhur këtij procesverbali, autoriteti kontraktor ka dorëzuar edhe dy mostra, për të cilat sqaron se janë materiale të printuara nga pajisja makineri për printim, stampim, materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK + E Bardhë +Llakim (Varnish). Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, si organ përgjegjës dhe përfituesi i drejtpërdrejtë i këtij shërbimi ka kryer verifikimet përkatëse bazuar në dokumentat e tenderit. Në këtë mënyrë autoriteti kontraktor, vërteton nëpërmjet akteve ligjore e verifikimeve të kryera se pajisjet e paraqitura nga operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k., kryejnë shërbimin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit.

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që

duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Print Point" sh.p.k. konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Promo Print" sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik "Print Point" sh.p.k. me argumentin se "*Sipas informacionit tregtar të disponuar nga ne rezulton që operatori ekonomik "Print Point" sh.p.k. nuk disponon teknologji dhe për rrjedhim nuk ofron në treg shërbimet për printim, skanim dhe fotokopjim A0. Duke u nisur nga ky fakt ne paragjykojmë në vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur për vërtetimin e zotërimit të teknologjisë dhe plotësimit të kriterit të kërkuar.[...]*" Si dhe pretendimin se "*Sipas informacionit tregëtar të disponuar nga ne rezulton se operatori ekonomik "Print Point" nuk ka pronësi sic kërkohet në kriteret e përcaktuara – Makineri shtypi. Duke u nisur nga ky fakt ne paragjykojmë në vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur për vërtetimin e zotërimit të teknologjisë dhe plotësimit të kriterit të kërkuar*" [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën e publikuar për ndryshimet në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

Ishte

3. Operatori ekonomik duhet te zoteroje pajisjet si me poshte:

-Makineri shtypi

-Makineri printim,fotokopjim, skanim A0

-Makineri per printim, stampim, materiale te ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+WHITE+VARNISH

Bëhet

3. Operatori ekonomik duhet te zoteroje pajisjet si me poshte:

-Makineri shtypi

-Makineri printim,fotokopjim, skanim A0

-Makineri per printim, stampim, materiale te ngurta, teknologjia UV, me ngjyrat CMYK+E BARDHE+LLAKIMI (VARNISH)

Gjithashtu, në shtojcë 7, të dokumentave të tenderit, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 3, paragrafi i dytë parashikohet:

[...] "Për pajisjet e mësipërme ofertuesi duhet të paraqesë: Një deklaratë lidhur me pajisjet që ka në dispozicion ku të specifikohet se autorizohet autoriteti kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në deklaratë, e shoqeruar me dokumentacionin që verteton pronësinë mbi pajisjet e mësipërme (fatura blerje të pajisjeve)."

III.3.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Print Point" sh.p.k., në lidhje me kriterin e mësipërm, rezulton se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

[...]

- Deklaratë për pajisjet që ka në dispozicion (konkretisht për pajisjet si më poshtë)
  1. Makineri shtypi
  2. Makineri printim, stampim, skanim A0
  3. Makineri, printim, stampim materiale të ngurta, teknologjia UV, me ngjyra CMYK + Ëhite + Varnish
- Faturë Nr. 14 datë 30.10.2010, për blerjen e pajisjes “printer, skaner A0”, me shitës “Vladimi Vani” p.f. dhe blerës “Print Point” sh.p.k.
- Faturë Nr. 16, datë 30.10.2010 për blerjen e pajisjes “Makineri shtypi dhe printimi”, me “Vladimi Vani” p.f. dhe blerës “Print Point” sh.p.k.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.3.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.3.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën. [...]

III.3.6. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.7. Operatori ekonomik ankimues në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me pretendimin e mësipërm ndër të tjera është shprehur: [...] “Referuar dokumentacionit të ofruar nga “Print Point” rezulton se fatura nr. 14 datë 30.10.2010 dhe nr. 16 datë 30.10.2018 janë veprime fiktive të kryera për të justifikuar pajisje që nuk ekzistojnë, kjo vërtetohet lehtësisht nga

*të dhënat që ekzistojnë në regjistrin tregëtar QKB, subjekti shitës “V.V” (i afërm i administratorit-aksioner Ervin Vani) me nipt KXXXXXXXXF dhe objekt veprimtarie “Internet Kafe” nuk mund të jetë tregëtar i pajisjeve të shtypit apo të tjera pajisje të pretenduara. [...].*

III.3.8. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt prokurimi, vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që për pajisjet e mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë lidhur me disponimin e tyre si dhe faturat e blerjes së këtyre pajisjeve. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.* Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.3.9. KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k. rezulton se, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e pajisjeve të kërkuara, operatori ekonomik “Print Point” ka dorëzuar deklaratën mbi pajisjet që disponon si dhe faturat përkatëse të blerjes së tyre, konkretisht faturën për blerjen e pajisjes makineri shtypi dhe printimi dhe faturën për blerjen e pajisjes Printer, Skaner A0. Pra, operatori ekonomik “Print Point” sh.p.k., vërteton nëpërmjet dy formave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet deklaratës lidhur me pajisjet që ka në dispozicion dhe faturave të blerjes, se disponon pajisjet e kërkuara.

Sa më sipër pretendimi i operatori ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Promo Print” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-42611-01-29-2018, me objekt “Shpenzime të printimit dhe publikimit”, me fond limit 4.532.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 561 Protokolli**

**Datë 20.03.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

